



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 510/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Vushtrri, paraqitur kundër Kryesuesit të Vendvotimit (KVV) 2703b/01 ne komunën e Vushtrris për shkak te parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i , më datën 04.11.2013, ka pranuar ankesë nga Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendohet se me datën 3 nëntor rreth orës 09:00 në vendvotimin 2703b/01 ka munguar libri i votimit dhe se përkundër kërkesës së bërë nga komisionari i LVV-së nuk është sjellë fare dhe nuk është marrë parasysh nga kryesuesi i vendvotimit Mentor Behrami i cili është i deleguar si komisionar nda PDK-ja

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LVP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore nga ana e LVV-se në vendvotimin 2703b/01 ka munguar libri i votimit janë të pabazuara nga shkakut se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë materiale që do të shërbente si dëshmi për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore me të cilat do të mund të administroheshin lëndët ose do të mund të verifikoheshin vërtetësia e shkëljes së pretenduar. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 510 /2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.